

**DHOMA E POSAÇME  
E GJYKATËS  
SUPREME TË  
KOSOVËS PËR  
ÇËSHTJE QË LIDHEN  
ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT**

**SPECIAL CHAMBER  
OF THE SUPREME  
COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST  
AGENCY RELATED  
MATTERS**

**POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU  
AGENCIJU**

**ASC-09-0048**

[REDACTED]

[REDACTED], Prishtinë

Përfaqësuar nga [REDACTED] avokat nga Prishtinë

Claimant/Appellant

vs

**Agjencioni Kosovar I privatizimit**

Prishtinë

Respondent

Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Paqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjen që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), e përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJ-së, Gjyqtar Kryesues, Trosten Frank Koschinka, Gjyqtar dhe Eija-Liisa Hekin, Gjyqtare, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me datë -----2009 lëshon këtë

#### **A K T V E N D I M**

Ankesa e [REDACTED] e datës 13 Gusht 2009 kundër Aktgjykimit SCA -08-0308 të datës 09 Korrik 2009 refuzohet si e pa bazuar.

#### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me Aktgjykimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në SCA-08-0308 të datës 09 Korrik 2009 është hedhur poshtë ankesa e [REDACTED] me të drejtë ankese në Dhomën e Posaçme konform dispozitave të nenit 9.5 të Rregullores së UNMIK 2008/4.

Kundër këtij Aktvendimi pala e pa kënaqur [REDACTED] ka paraqitur ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, me 13 Gusht 2009, me të cilën ka kërkuar që Aktvendimi i shkallës së parë SCA -08-0308 të datës 09 Korrik 2009 të refuzohet dhe të miratohet kërkesa për pagimin e të ardhurave mujore prej 01.03.2000 deri me 27.06.2006 në shumen prej 21.500.00 me kamat përkatëse sipas kamatës bankare në emër të kontributit pensional në [REDACTED]

Në ankese ka theksuar se Gjykata e shkalles së parë nuk i ka vlerësuar drejte dhe plotësisht rrethanat vendimtare nga të cilat varet marrja e aktvendimit. Si shkak kryesor për hedhjen e kërkesës padisë është marre fakti se paditësi nuk ka paraqitur padinë e plotësuar sipas kushteve të parapara me dispozitën e nenit 28.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6, gjegjësisht nuk e ka njoftuar Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit se ka qellim të paraqes padinë kundër saj. Sipas kësaj ankese thuhet se Vendimi shkalles së parë pjesërisht është i bazuar, megjithëse Dhoma Veçanet e Gjykatës Supreme duhet të lëshojë ne procedues meritore për vlerësimin bazëueshmerisë së ankesës.

Paditësi në ankesën e tij thekson se, gjykata e shkalles së parë ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe manifestohet faktin se provat relevante nuk janë vlerësuar drejtë dhe plotësisht.

E paditura Agjencionin Kosovar të Mirëbesimit - Prishtinë, nuk ka paraqitur përgjigje në ankese.

### **Arsyet Ligjore**

Kolegji i Ankesave pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që e shqyrtoj aktvendimin e kundërshtuar dhe i analizoi pretendimet ankimore të paraqitura në ankese, konform dispozitës së nenit 365 par. 2 dhe 366 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjeti se ankesa nuk është e bazuar.

Gjykata e shkalles së dytë i ka zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe se aktvendimi nuk përmban shkelje esenciale, të dispozitave të procedurës kontestimore.

Pretendimet ankimore të theksuara në ankese, përkitazi me shkeljet esenciale të bëra nga ana e gjykatës së shkallës së parë të paraqitura në mënyrë të përgjithësuar, pa konkretizim të bazës ligjore, se me çfarë konsistojnë ato shkelje, Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme konstaton se ato janë të paargumentuara. Përkundrazi, aktgjykimi i gjykatës së shkalles së parë përmban shpjegime dhe arsyetime të mjaftueshme, të cilat janë të mbështetura në prova relevante dhe në dispozita ligjore të aplikueshme.

Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme konstaton se paditësi nuk e ka paraqitur padinë e kompletuar apo të korrigjuar, e cila duhet të përmbush kushtet e parapara sipas nenit 28.2(f) të UA të UNMIK-ut 2008/6 dhe të paraqes dokumente të kërkuara sipas kërkesës dhomës së posaçme.

Paditësi nuk ka parashtruar njoftim AKP më qellim që të parashtrroj padi kundër Ndërmarrjes apo Agjencisë në periudhën e paraparë sipas nenit 29.1 apo 30.2 të UNMIK 2008/6

Dhoma posaçme ka shqyrtuar me kujdes padinë dhe dokumente dhe ka konstatuar se Paditësi nuk iu është përmbajtur dispozitës si me lartë prandaj padia duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në bazë të nenit 28.3 të UA të UNMIK-ut 2008/6. sipas secilës paditësi nuk është përmbajtur kushteve të përcaktuara të pargrfait (a) e gjer (e) të nenit 28.3 të UA- UNMIK-ut 2008/6.

Në mbështetje të nenit 368 të LPK-se e lidhur nën 62 pika (a) të Urdhërësës administrative të UNMIK-ut nr. 2006/17, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues-it  
EULEX

---

Torsten Koschinka, Gjyqtar  
EULEX

---

Eija -Liisa Helin, Gjyqtare e EULEX-it

---

Tobias Lapke, Regjistruer  
EULEX-it

---